



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit ARPL Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No. 419-2/26

Nr. I faqeve Broj. stranica No. pages -04- Data. Datum. Date. 17.07.2026

PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planing

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	17.07.2026
REFERENC-Ë:	419/26 - ZSP 2026 ; ARPL
PËR/ZA/TO:	„ISEFERI” SH.P.K. Zona Ind. Shirokë, K. Suharekë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram KAFEXHOLLI, U.D Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së Z. Zymer MRASORI, U.D Drejtor i ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Pellumbesha SPAHIU, Zyrtare e lartë për leje ujore shkarkim të ujit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Vazhdim i Lejes Ujore, Shkarkim Nr.Prot 52/21

Të nderuar,

Bazuar në kërkesën me Nr. Protokolli 419/26 të datës 29.01.2026, nga pala “ISEFERI” SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 810106204 në Zonën Ind. Shirokë, Komuna e Suharekës, për vazhdimin e lejes ujore për shkarkim të ujit, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pas shqyrtimit të lëndës dhe shikimit në vend ka vendosur si në Vendim për Vazhdim të Lejes Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt !



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalno Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. L.U.

Datë: 17.07.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, nenit 17 të Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerrë këtë:

VENDIM

APROVOHET kërkesa e palës **“ISEFERI” SH.P.K.**, Komuna Suharekë me nr. protok. 419/26, datë 29.01.2026, për Vazhdimin e Lejes Ujore me Nr. Prot. 52/21 datë 09.02.2021 për shkarkim të ujërave nga baza për prodhim të betonit dhe elementeve të betonit në koordinatat: X= 7 463 294; Y= 4 689 551

1. Leja Ujore vazhdohet në bazë të plotësimit të kushteve të lejes ujore paraprake si dhe dokumentacionit për vazhdim të lejes ujore për shkarkim të ujërave të ndotura nga baza për prodhim të betonit dhe elementeve të betonit.
2. Afati i lejes ujore është 5 (pesë) vjet, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës.
3. Ujërat teknologjike të gjeneruara gjatë procesit të prodhimit duhet të menaxhohen përmes bazenit sedimentues dhe sistemit të riciklimit, me ripërdorimin e tyre në procesin teknologjik. Çdo shkarkim eventual i ujërave të ndotura duhet të kryhet në përputhje me kushtet, mënyrën dhe parametrat e caktuar në U.A. MMPHI –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor ndërsa rezultatet e analizave duhet të raportohen në MMPH/ARPL, duke përfshirë koordinatat e pikës së hyrjes së ujërave në impiant dhe pikës së shkarkimit.

Arritja e vlerave kufizuese të shkarkimit të substancave ndotëse të ujërave të ndotura nuk mund të bëhet përmes hollimit.



4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë.
5. Në rast të ndryshimit të regjimit të ujërave gjatë operimit dhe shkaktimit të dëmeve të mundshme ndaj mjedisit apo palëve të treta, investitori është i obliguar për evidentim dhe kompensim të tyre.
6. Gjatë shkarkimit të ujërave të ndotura, pala obligohet të bëjë matjen dhe evidentimin e sasisë së ujërave të shkarkuar përmes pajisjes ujëmatëse të instaluar në pikën e shkarkimit.
7. Pajisja ujëmatëse duhet të jetë e tillë që të mundësojë matjen e saktë të ujërave të shkarkuar.
8. Pala obligohet të evidentojë dhe të raportojë në MMPH/ARPL sasinë e ujërave të shkarkuara, të matur përmes pajisjes ujëmatëse.
9. Gjate vendosjes së pajisjes ujëmatëse detyruesi obligohet që vendosjen të bëjë nën mbikëqyrjen e inspektoratit të Ministrisë.
10. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin e ujërave të ndotura, do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas **U.A. MMPHI –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor**”.
11. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore nuk mund t’u barten personave të tretë, pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore.
12. Për vazhdimin e sërishëm të Lejes Ujqore bartësi është i obliguar që të aplikoj së paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të kësaj Leje Ujqore.
13. Validiteti i Lejes Ujqore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ujërave, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës “ISEFERI” SH.P.K për vazhdim të lejes ujqore për shkarkim me nr. Prot. 419/26, andaj ky vendim për vazhdim të lejes ujqore për shkarkim uji është nxjerrë mbi bazën e dokumentacionit teknik dhe dokumenteve vijuese: Aplikacion për vazhdim të lejes ujqore shkarkim uji: Kopja e dokumentacionit tekniko-investig për lejen ujqore paraprake; Certifikata e Biznesit me NUI 810106204; Certifikata e TVSH-së me nr 330384644; Kopja e ID-së së përfaqësuesit të autorizuar; Dëshmia mbi pagesën e tarifës administrative për vazhdimin e lejes ujqore sipas shtojcës Nr.6, të U.A. 03/2018, për tarifën e shërbimit gjatë procesit të lëshimit të akteve ujqore; Kopja e vendimit të Lejes Mjedisore me Nr. 5705/20/MMPHI, datë: 07.06.2021; Kopja e vendimit të Lejes Ujqore për shkarkim uji me Nr. Prot. 52/21 datë 09.02.2021; Pjesa sipas Vendimit Financiar me Nr. Prot. 53-2/21, datë 13.06.2022; Pjesa sipas Vendimit Financiar me Nr. Prot. 52-2/21, datë 26.04.2023; Pjesa sipas Vendimit Financiar me Nr. Prot. 52-2/20, datë 30.03.2026.



Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit shoqërues dhe realizimit të shikimit në vend, është vendosur si në dispozitiv.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr. 419/26 - ZSP- 2026 Datë: 17.07.2026
Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Komunës së Suharekës;
- Arkivit të MMPH-së

U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së


Bajram KAFEXHOLLI

